

1 E diel, 8 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari Fazliu hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 13.10

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se vini
7 të gjithë në seancën për Paraqitjen e Parë.

8 Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është
10 çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori Specializuar kundër Hashim
11 Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe
12 Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

14 Përpara që të fillojmë do t'i jap fotografit mundësinë që
15 të bëjë disa fotografi.

16 Z. Fazliu, a jeni dakord që fotografi të bëjë disa
17 fotografi edhe të juve sot?

18 I AKUZUARI FAZLIU: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ndizni mikrofonin. Nuk
20 morëm përgjigje nga z. Fazliu akoma.

21 I AKUZUARI FAZLIU: Po.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Fazliu.

23 Znj. Fotografe, mund të bëni fotografitë. Faleminderit,
24 znj. Fotografe.

25 Përpara se t'ju kërkoj të pranishme në sallën e gjyqit që

1 të prezantohen, do të doja t'ju kujtoj të gjithëve rregullat
2 që duhet të respektohen në çdo kohë me qëllim që kjo procedurë
3 të zhvillohet në mënyrë sa më të mirë.

4 Kontrolloni ju lutem që mikrofoni të jetë ndezur përpara
5 se të flisni dhe që fikeni atë sapo të mbaroni. Flisni ngadalë
6 dhe në mënyrë të qartë sepse bëhet përkthimi në gjuhën shqipe
7 dhe serbisht. Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni
8 apo t'i jepni përgjigje palëve me qëllim që përkthyesit të
9 kenë kohë të mbarojnë përkthimin.

10 Gjithashtu ju kujtoj që disa informacione në këtë lëndë
11 janë konfidenciale. Informacionet konfidenciale nuk zbulohen
12 në seancë të hapur. Në qoftë se ndonjë prej palëve dëshiron
13 t'i referohen apo të diskutojnë informacion konfidencial, në
14 këtë rast kërkohet të kalojnë në seancë private.

15 Tani ju kërkoj palëve që të prezantohen duke filluar me
16 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

17 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëdita, znj. Gjykatëse. Unë jam
18 Josh Hafetz, përfaqësoj Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
19 Bashkë me mua është kolegia ime Kim West, Prokurore e
20 Specializuar, që është ulur prapa meje, dhe Gaia Pergolo, në
21 anën time të majtë, Fabian Unser-Nad në rreshtin mbrapa.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani Mbrojtja.

24 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Unë quhem Michiel
25 Pertman, Michiel Pestman dhe jam avokati i të akuzuarit.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

2 Konstatoj që klienti juaj, z. Fazliu, është i pranishëm
3 në sallën e gjyqit.

4 Tani i kthehem Zyrës Administrative.

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse. Për
6 procesverbal unë jam Jonas Nilsson, Zëvendësadministrator. Jam
7 këtu me Whitney Price, që është këshilltar ligjor.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

9 Për procesverbal, unë jam Marjorie Masselot, Gjykatësja e
10 Procedurës Paraprake.

11 I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të
12 Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij me datë
13 29 nëntor 2024.

14 Z. Fazliu, ju lutem ngrituni në këmbë dhe ndizni
15 mikrofonin.

16 A mund të na jepni emrin dhe mbiemrin ju lutem?

17 I AKUZUARI FAZLIU: Po. Fadil Fazliu.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Datëlindja dhe vendlindja
19 ju lutem?

20 I AKUZUARI FAZLIU: 15 korrik 1960, Llaushë, komuna e
21 Podujevës. Vendbanim në Prishtinë.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Dhe shtetësia apo
23 shtetësitë tuaja në qoftë se keni më shumë se një?

24 I AKUZUARI FAZLIU: Vetëm një, i Kosovës.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Profesionin juaj i

1 tanishëm?

2 I AKUZUARI FAZLIU: Jam magjistër i shkencave emergjente,
3 mbrojtja, siguria në punë.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
5 z. Fazliu.

6 I AKUZUARI FAZLIU: Faleminderit.

7 Z. PESTMAN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që ju ndërpreva, e
8 di që nuk është shumë i vjetër, po nuk ka lindur në 1996, por
9 në 1960.

10 I AKUZUARI FAZLIU: 1960 thashë. 15 korrik 1960.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani u korigjua. U
12 shënuar në procesverbal.

13 Z. Fazliu, përpara që të vazhdojmë më tej, dua të
14 sigurohem që ju jeni në gjendje të ndiqni zhvillimin e kësaj
15 procedure në gjuhën që e kuptoni dhe e flisni. A mund të
16 konfirmoni që e kuptoni dhe e flisni gjuhën shqipe?

17 I AKUZUARI FAZLIU: Po.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Fazliu.

19 Tani jam bindur që ju mund të ndiqni zhvillimin e
20 procedurës në shqip që është gjuhë që e kuptoni dhe e flisni
21 në përputhje me rregullën 92 të Rregullores së Procedurave dhe
22 Provave.

23 Në qoftë se gjatë zhvillimit të kësaj procedure në ndonjë
24 moment të caktuar nuk ju vjen përkthimi, ju lutem na e bëni të
25 ditur menjëherë. Mund të uleni tani.

1 Tani, për të filluar paraqitjen e parë të sotme do të jap
2 një historik të shkurtër procedurale.

3 Më datë 29 nëntor 2024, në cilësinë time si Gjykatëse e
4 Procedurës Paraprake kam konfirmuar pjesërisht aktakuzën e
5 parashtruar nga Prokurori i Specializuar kundër zotërinjve
6 Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe
7 Hajredin Kuçi në të cilën akuzohej z. Fazliu, ju, pra, me një
8 pikë për përpjekje për të penguar persona zyrtarë në kryerjen
9 e detyrave të tyre zyrtare duke marrë pjesë në një veprim të
10 përbashkët në grup dhe një pikë për mosbindje ndaj Gjykatës.

11 Gjithashtu kam lëshuar urdhrin e arrestit për arrestimin
12 e z. Fazliu me të njëjtën ditë.

13 Me 5 dhjetor 2024, ZPS-ja arrestoi z. Fazliu në Kosovë
14 dhe atij u dorëzua urdhri i arrestit, Aktakuza e Konfirmuar
15 dhe vendimi për urdhër-arrestin e tij përkthyer në gjuhën
16 shqipe.

17 Më 6 dhjetor 2024, z. Fazliu u transferua në qendrën e
18 paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.
19 Po atë ditë, nxora vendimin ku përcaktohej data për paraqitjen
20 e parë.

21 Tani më lejoni të shpjegoj arsyen konkrete të paraqitjes
22 së parë në interes të z. Fazliu.

23 Seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk do të paraqiten apo
24 të diskutohen prova dhe nuk do të diskutohet apo të merret
25 vendim mbi fajësinë apo pafajësinë.

1 Qëllimi i paraqitjes së parë, i seancës së paraqitjes së
2 parë rregullohet nga neni 39(5) i Ligjit dhe nga rregulla 92 e
3 Rregullores. Sipas këtyre dispozitave, Gjykatësja e Procedurës
4 Paraprake, në këtë cilësi do të lexojë akuzat në Aktakuzën e
5 Konfirmuar për të akuzuarin:

6 Konfirmoj që i akuzuari kupton aktakuzën;

7 Të bindem që të drejtat e të akuzuarit, në veçanti të
8 drejta lidhur me avokatin e tij respektohen;

9 Të informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga seanca e
10 sotme do t'i jepet mundësia që të deklarohej fajtor apo i
11 pafajshëm për secilën prej pikave të akuzës të paraqitura në
12 aktakuzë. Nëse i akuzuari dëshiron ta bëjë një gjë të tillë,
13 mund ta bëjë menjëherë, pra, të pranojë fajin apo të
14 deklarohej i pafajshëm.

15 Dhe, në fund, do të caktoj data të tjera sipas nevojës
16 për kryerjen e funksioneve të mia si Gjykatëse e Procedurës
17 Paraprake.

18 Këto janë çështje që do të trajtohen gjatë seancës së
19 sotme të Paraqitjes së Parë. Në qoftë se ndonjë nga palët
20 dëshirojnë të diskutojnë në çështjet e tjera, të cilat nuk
21 parashihen shprehimisht në kontekstin e Paraqitjes së Parë, ju
22 ftoj të bëni këtë përmes një parashtrimi me shkrim.

23 Së pari, z. Fazliu, ju ftoj që të ngriheni në këmbë. Do
24 t'ju kërkoja të konfirmoni që keni pranuar, marrë Aktakuzën e
25 Konfirmuar në gjuhën që kuptoni dhe flisni?

1 I AKUZUARI FAZLIU: Po, e kam pranue.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Fazliu, përpara se znj. Sekretare të lexojë Aktakuzën
4 e Konfirmuar, pikat e aktakuzës kundër jush, dëshiroj t'ju
5 rikujtoj se ky nuk është momenti për t'i kundërshtuar ato, por
6 thjesht për të konfirmuar që ju i kuptoni ato. Mundësia për
7 t'i kundërshtuar akuzat do t'ju jepet me ndihmën e avokatit
8 tuaj.

9 Tani do t'i kërkoj znj. Sekretare të Gjykatës që të
10 lexojë pikat e aktakuzës në Aktakuzën e Konfirmuar siç
11 parashihen në nenin 39(5) të Ligjit dhe rregullën 92(2)(b) të
12 Rregullores.

13 Mund të uleni, z. Fazliu.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 1. Në Aktakuzën e
15 Konfirmuar, Prokurori i Specializuar akuzon z. Fazliu me:

16 Pika 16: Përpjekje për të penguar persona zyrtarë, në
17 veçanti prokurorë dhe hetues të ZPS-së, në kryerjen e detyrave
18 të tyre zyrtare duke marrë pjesë në një veprim të përbashkët
19 në grup, që ndëshkohet sipas nenit 401(2) dhe (50 të Kodit
20 Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe neni 15(2) i Ligjit; dhe

21 Pika 17: Mosbindje ndaj Gjykatës, që ndëshkohet nga neni
22 393 i Kodit Penal të Kosovës i vitit 2019 dhe neni 15(2) i
23 Ligjit.

24 2. Këto vepra penale janë kryer mes të paktën datë 26
25 qershor dhe 18 korrik 2023.

1 3. Lidhur me këto vepra penale ekziston dyshimi i bazuar
2 mirë se z. Fadil Fazliu është penalisht përgjegjës në pajtim
3 me nenin 16(3) të Ligjit, për:

4 a. Kryerjen e veprës penale të përpjekjes për të penguar
5 persona zyrtarë në kryerjen e detyrës së tyre zyrtare nga Pika
6 16, sipas nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

7 b. Ndihmë dhënë z. Hashim Thaçi në kontekstin e një grupi
8 në kryerjen e veprës penale të përpjekjes për të penguar
9 persona zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare sipas
10 pikës nga Pika 16 dhe sipas nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës
11 të vitit 2019.

12 c. Dhënie ndihme z. Hashim Thaçi në kryerjen e veprës
13 penale të mosbindjes ndaj Gjykatës paraqitur në Pikën 17,
14 sipas nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

15 d. Marrëveshje për të kryer bashkë me z. Hashim Thaçi në
16 kontekst të një grupi kryerjen e veprës penale të përpjekjes
17 për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre
18 zyrtare nga Pika 16, sipas nenit 35 të Kodit Penal të Kosovës
19 të vitit 2019.

20 Faleminderit, z. Gjykatëse.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

22 Sekretare.

23 Z. Fazliu, i kuptuat akuzat që gjenden në Aktakuzën e
24 Konfirmuan të cilat u lexuan nga Sekretarja?

25 I AKUZUARI FAZLIU: Pjesërisht. Po.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] A ka diçka që nuk e
2 kuptuat sepse m'u duk se thatë pjesërisht?

3 I AKUZUARI FAZLIU: Po, po, i kam kuptue. Po, po.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Është në
5 procesverbal e shënuar.

6 Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
7 Procedurës dhe Provave ju garanton disa të drejta. Do t'ju
8 lexoj ato më të rëndësishme, sidomos ato që janë relevante në
9 këtë fazë të procedurës.

10 Z. Fazliu, juve prezumoheni i pafajshëm deri në momentin
11 kur jeni shpallur fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm.

12 Në përcaktimin, në vërtetimin e akuzave ndaj jush keni të
13 drejtën që të keni seanca publike dhe të drejta, përveç
14 rasteve kur urdhërohen masa të caktuara për mbrojtjen e
15 viktimave apo dëshmitarëve.

16 Keni të drejtën të informoheni menjëherë dhe me hollësi
17 në gjuhën që kuptoni për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër
18 jush.

19 Keni të drejtën të keni kohë të mjaftueshme dhe mundësi
20 të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen tuaj, për të
21 komunikuar me avokatin që ju e zgjidhni.

22 Keni të drejtën të gjykoheni brenda një kohe të
23 arsyeshme.

24 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
25 mbroheni përmes avokatit.

1 Keni të drejtën të keni avokat, që t'ju caktohet një
2 avokat pa pagesë në qoftë se nuk keni mundësi të mjaftueshme
3 financiare për të paguar.

4 Keni të drejtën që të keni përkthyes falas nëse nuk
5 kuptoni ose nuk flisni gjuhën e përdorur në Gjykatë.

6 Keni të drejtën që të mos detyroheni të jepni dëshmi
7 kundër vetes apo të pranoni fajësi.

8 Keni të drejtën të qëndroni në heshtje dhe të qëndruarit
9 në heshtje nuk ka ndikim negativ tek ju.

10 Keni të drejtën që të mos mbaheni në paraburgim për një
11 periudhë kohore të paarsyeshme përpara fillimit të gjykimit,
12 keni të drejtën të kërkonti rishikimin e vendimeve lidhur me
13 paraburgimin tuaj dhe të bëni, paraqisni apel ndaj këtyre
14 vendimeve dhe me një drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit.

15 Z. Fazliu, ju lexova të drejtat më të rëndësishme,
16 kryesore të cilat keni në përputhje me kornizën ligjore të
17 zbatueshme të Dhomave të Specializuara. I kuptoni këto të
18 drejta?

19 I AKUZUARI FAZLIU: Po.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Pra, ju lexoj, në pajtim
21 me nenin keni të drejtën, me nenin 21(5) të Ligjit keni të
22 drejtën -- nuk keni të drejtë që të përfaqësoheni vetë sepse
23 jeni në paraburgim. Përfaqësoheni nga një avokat i
24 specializuar që është e detyrueshme.

25 Dhe konstatoj se z. Pestman ju përfaqëson sot. Dhe jam,

1 pra, i bindur që i akuzuari është i përfaqësuar sot në Gjykatë
2 nga avokati.

3 I AKUZUARI FAZLIU: Po, po. Po.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Do ta
5 përsëris, pra, ju informova se në pajtim me nenin 21(5) të
6 Ligjit nuk mund të përfaqësoni vetveten sepse aktualisht
7 gjendeni në paraburgim. Është e detyrueshme që të
8 përfaqësoheni nga një avokat i specializuar dhe sapo
9 konstatova që përfaqësoheni nga avokati Pestman dhe për
10 rrjedhojë jam plotësisht e bindur që sot jeni i përfaqësuar
11 nga avokati juaj.

12 Tani do t'i kthehem të drejtës që keni ju për të
13 deklaruar lidhur me fajësinë tuaj menjëherë në pajtim me
14 rregullën 92 të Rregullores.

15 Z. Fazliu, brenda 30 ditësh nga sot, siç e përmenda dhe
16 më herët, do t'ju jepet mundësia që të deklarojeni për
17 fajësinë apo pafajësinë tuaj lidhur me pikat e aktakuzës. Nëse
18 dëshironi të bëni një gjë të tillë menjëherë, pra, të pranoni
19 fajësinë apo të deklarojeni i pafajshëm mund ta bëni.

20 Për rrjedhojë, z. Fazliu do t'ju pyes nëse keni pasur
21 mundësinë të diskutoni pikat e akuzës në Aktakuzën e
22 Konfirmuar me avokatin tuaj dhe nëse jeni i gatshëm që të
23 deklaroni mbi fajësinë apo pafajësinë tuaj tani.

24 I AKUZUARI FAZLIU: Po, do të deklarojem i pafajshëm. Kam
25 diskutu me avokatin ka një orë e diçka, po unë jam i

1 pafajshëm. Deklarohem i pafajshëm.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E keni konstatuar këtë.
3 Meqenëse zgjodhët që të deklaroheni i pafajshëm për të gjitha
4 pikat e aktakuzës, Gjykatësja -- procedurat paraprake do të
5 vazhdojnë duke patur parasysh përgatitjen për gjykimin në këtë
6 çështje në pajtim me rregullën 95 të Rregullores.

7 Tani kalojmë tek gjuha e përdorur në këtë procedurë.

8 Në vendimin ku përcaktohej data për paraqitjen e sotme,
9 ftova palët që të bëjnë parashtrime gojore në seancën e sotme
10 lidhur me gjuhën e përdorur në këtë çështje sipas rregullës 8
11 të Rregullores dhe do të doja tani të dëgjoj për referencën që
12 kanë secila palë.

13 Do t'i jap fjalën fillimisht Zyrës së Prokurorit lidhur
14 me këtë.

15 Z. HAFETZ: [Përkthim] Në anglisht. Faleminderit.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Pestman.

17 Z. PESTMAN: [Përkthim] Anglisht edhe ne.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E shënuam. Do të nxjerr
19 një vendim lidhur me këtë në kohën e duhur.

20 Në vendimin ku përcaktohet data për paraqitjen e parë të
21 sotme, kam dhënë, shprehur qëllimin që të caktojmë seancën e
22 parë për konferencën mbi ecurinë e çështjes më datën 17
23 dhjetor 2024 në orën 14.00. Gjithashtu, ftova palët që të
24 paraqesin parashtrimet gojore në seancën e parë për paraqitjen
25 e parë të sotme lidhur me faktin nëse avokati ose i akuzuari

1 synojnë të marrin pjesë në konferencën për ecurinë e çështjes
2 ose do të marrin pjesë përmes videolidhjes.

3 Avokati Pestman, ju e keni fjalën.

4 Z. PESTMAN: [Përkthim] Klienti im dhe unë do të marrim
5 pjesë fizikisht në seancë.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. U konstatua.
7 Prokurori, juve?

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do të jemi këtu personalisht edhe
9 neve.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

11 Do t'ju dërgohet kalendari në kohë ku do të përfshihet
12 dhe agjenda dhe seancat e rregulluara sipas Rregullores.

13 Tani do të kalojmë te pika e radhës që ka të bëjë me
14 paraburgimin e z. Fazliu.

15 Z. Fazliu, kujtoj se bazuar në konstatimin e dyshimit të
16 bazuar mirë që ju keni kryer veprat penale që sapo u lexuan
17 dhe urdhri i arrestimit i lëshuar ndaj jush më 29 dhjetor
18 [Sipas përkthimit] 2024. Në pajtim me nenin 41(6)(b) të Ligjit
19 arrestimi juaj është konstatuar të jetë i nevojshëm dhe i
20 domosdoshëm bazuar në ekzistencën e arsyeve të artikulueshme
21 për të besuar që ekziston rreziku i arratisjes, që ju mund të
22 pengoni ecurinë e procedurës penale dhe mund të përsërisni
23 veprat penale të përmendura.

24 Gjithashtu kujtoj që juve ju është dhënë urdhri për
25 arrest bashkë me vendimin e arsyetuar dhe kërkesën për urdhër-

1 arrest dhe çështjet e lidhura me to të përkthyer në gjuhën
2 shqipe bashkë me Aktakuzën e Konfirmuar.

3 Tani do të doja të di nëse Mbrojtja dëshiron të bëjë
4 parashtrime lidhur me çështjen e paraburgimit.

5 Z. PESTMAN: [Përkthim] Po numëroj deri në 5. Mendoj që
6 po, e nderuar Gjykatëse. Do të doja të kërkoj lirimin e
7 përkohshëm të klientit tim me garanci financiare.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Padyshim që mund ta bëni.
9 Pres që ta bëni këtë, këtë kërkesë.

10 Z. PESTMAN: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Jam
11 takuar me klientin tim vetëm dje dhe nuk kam biseduar me të
12 për një kohë të gjatë dhe do të doja që të ta prezantoja atë
13 juve që ta njohim më mirë. Dhe do të doja t'ju them që edhe
14 pse, juve dhe Prokurori, diçka lidhur me rrethanat e tij
15 personale që mendoj janë relevavnte për vendimin që do të
16 merret shpresoj sot lidhur me paraburgimin.

17 Ai është arrestuar, pra, klienti im është arrestuar
18 ndërsa po bëhej gati për të shkuar në punë. Siç ka thënë,
19 ecte, ishte në këmbë për të shkuar në punë. Punon, siç është
20 shpjeguar, si koordinator për zyrën qendrore të zyrës së
21 furnizimit me energji elektrike në Prishtinë. Kjo është një
22 institucion qeverisës i shtetit. Është kompani e furnizimit
23 energjisë. Dhe po ju them këtë sepse është e rëndësishme sepse
24 ai pret dhe ka frikë që do të humbasë vendin e punës në qoftë
25 se mbahet në paraburgim për një kohë të gjatë.

1 Aktualisht rruga e tij është 850 euro në muaj, që ngelin
2 650 pas pagimit të taksave dhe ka kursime më pak se 1000 euro
3 para të kursyera. Po ju them këtë duke patur parasysh
4 përcaktimin e shumës së garancisë financiare për ta liruar
5 atë.

6 Ai jeton në Prishtinë me gruan, djalin dhe vajzën. Djali
7 punon, ka të ardhura 500 euro në muaj dhe vajza është
8 studente. Të dy janë rreth 20 vjeç.

9 Ka probleme shëndetësore të rënda. Nuk do të hyj në
10 hollësi, por ka probleme me zemrën, për të cilën ka nevojë për
11 kujdesje mjekësore të veçantë dhe ka dhe vuan nga diabeti.
12 Natyrisht, në Kosovë është nën trajtim të specializuar
13 mjekësor.

14 Siç e thashë, është i shqetësuar që mund të humbasë
15 punën, duke humbur edhe rrogën dhe kjo do të ketë pasoja të
16 menjëhershme dhe të rënda për të dhe për familjen e tij. Ka
17 një adresë vendbanimi, që nuk është e vështirë ta gjeni në
18 qoftë se ka nevojë ta kërkon.

19 Duke marrë parasysh rrethanat e tij personale, besoj që
20 ka pak gjasa që klienti im të arratiset. Është shumë e
21 rëndësishme për atë që të kujdeset për familjen e tij.

22 Që ta bëjmë të qartë, nuk ka pasaportë të Shqipërisë dhe
23 nuk ka gjasa, pra, që të ikë në Shqipëri, që do ta vinte atë
24 një situatë ku do të ishte larg mundësisë për t'u marrë nga
25 kjo Gjykatë.

1 Siç e dini, në të drejtën humanitare ndërkombëtare,
2 rregulla është që një i akuzuar mund të presë, nuk do të
3 mbahet në paraburgim në pritje të gjykimit. Ai ka të drejtën
4 që të jetë i lirë përveç rasteve kur ka rrethana të veçanta që
5 kërkojnë paraburgimin e tij, veçanërisht rrethana që kërkojnë,
6 të cilat janë të nevojshme për të siguruar që i akuzuari do të
7 marrë pjesë në gjykime.

8 U habita pak. Kjo është hera e parë që paraqitem në këtë
9 Gjykatë. U habita se mu dorëzuan shumë dokumente, dosje
10 ligjore, ndonjëherë edhe që përsërisnin të njëjtat
11 informacione dhe i kam lexuar dhe konsultuar hollësisht, po
12 nuk kam parë asnjë provë që mbështesin pretendimet dhe akuzat
13 në aktakuzë. Mendoj se duhet të ketë të tilla, por unë nuk i
14 kam parë.

15 Klienti im nuk pa as ai. Po e theksoj këtë pikë, po
16 këmbëngul në këtë pikë, sepse do të ishte e pamundur për
17 klientin tim, nuk e di cilët janë provat, cilët janë
18 dëshmitarët që do të dëshmojnë në këtë çështje, do të jetë
19 shumë e vështirë, do të ishte shumë e vështirë për klientin
20 tim që të pengojë drejtësinë në këtë çështje. Mesa kuptoj dhe
21 shtëpia e tij është bastisur. Telefoni është sekuestruar i
22 tij. Dhe nuk e di, nuk imagjinoj, imagjinata ime nuk më jep
23 mundësi që të shof se çfarë mund të bëjë klienti im për të
24 penguar drejtësinë në këtë moment të veçantë.

25 Gjithashtu, u habita sot në mëngjes, kur më thanë që jo

1 të gjitha të akuzuarit në këtë çështje dhe, po flasim për një
2 çështje dhe më të madhe, që do të na marrë kohë sot edhe
3 nesër, u habita kur më thanë që jo të gjithë të akuzuarit janë
4 arrestuar, disa prej tyre, të paktën njëri prej tyre, i është
5 dhënë fletë-thirrja për paraqitje në Gjykatë. Nuk e di, pse në
6 këtë rast të caktuar është vlerësuar si e mjaftueshme se të
7 dorëzohej një fletë-thirrje, ndërsa në rastin e klientit tim
8 të arrestohej.

9 Nuk duhet të jem i pasjellshëm, nuk dua të irritoj
10 klientin tim, por ai është një peshk i vogël në këtë hetim.
11 Mos kemi mosbindjen ndaj Gjykatës, në të cilën pretendohet që
12 ai të ketë dhënë ndihmë apo të ketë marrë pjesë, është
13 përpjekja për të ndikuar në dëshmitarë. Dhe nëse i kuptoj
14 pikat e akuzës saktë, ai nuk ka arritur ta bëjë këtë gjë nëse
15 lexojmë urdhrin për arrestim dhe Aktakuzën e Konfirmuar, pra,
16 nuk ka patur sukses, nuk ka arritur që në fakt të ndikojë në
17 dëshmitarë. Pra, peshk i vogël. Dhe mendoj që kjo duhet të
18 merret parasysh gjatë marrjes së vendimit për paraburgimin.

19 Do të doja të kërkoj lirimin e tij me garanci financiare
20 në Kosovë, pra, të klientit tim dhe do të doja që ju të
21 përcaktoni shumën e kësaj garancie, e nderuara Gjykatëse, në
22 shumën prej 2550 euro, që përputhet me tre muaj rrogë që ai
23 merr. Dhe do të doja që, dhe ju ftoj, e nderuara Gjykatëse, që
24 me qëllim që të urdhëroni ndonjë masë tjetër apo kushte të
25 tjera që mund t'ju vlerësojnë të domosdoshme për të siguruar

1 praninë e klientit tim në Gjykatë dhe në gjykim. Nuk mendoj që
2 arresti shtëpiak është opsioni i realizueshëm, mundësi e
3 realizueshme sepse ai ka nevojë të shkojë në punë çdo ditë.
4 Por përveç këtyre këtij kushti të veçantë, mendoj që do të
5 ftoja të gjithë të përfshirë dhe palët e përfshira këtu, e
6 nderuara Gjykatëse, që të jeni sa më kreativë që të jetë e
7 mundur.

8 Gjithashtu, kuptoj dhe dëgjova që ju i shpjeguat klientit
9 tim se ai është në paraburgim sepse ekziston frika se ai mund
10 të ripërsërisë veprën penale. Mendoj që është e lehtë të
11 gjejmë një zgjidhje dhe këtij problemi nëse ai -- nëse ju
12 urdhëroni atë që të vendosni kushtin që ai të mos largohet nga
13 Kosova, besoj që do të ishte shumë e vështirë që ai të gjejë
14 mënyrën që të ripërsërisë veprën penale.

15 Faleminderit.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

17 z. Prokuror, ju e keni fjalën.

18 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

19 Znj. Gjykatëse, do t'i përgjigjem shkurtimisht disa
20 pikave të ngritura nga Avokati.

21 Kryesisht do të mbështetem tek konstatimet tuaja, e
22 nderuara Gjykatëse, që janë paraqitur me hollësi në veçanti në
23 paragrafin 81 deri në paragrafin 92 të F00037, që besoj
24 Avokati e ka marrë dhe supozoj që e ka lexuar. Nuk jam i
25 sigurtë që ky është një parashtrimet të cilit ju referua si

1 përsëritës, kur përmendi fjalën përsëritës, por nuk duhet --
2 por duhet të përmend, duhet të diskutoj disa nga konstatimet
3 që përmban ky dokument.

4 Së pari, e nderuara Gjykatëse, konstatojmë se mendojmë që
5 është e qartë, jemi të gjithë dakord për ligjin e zbatueshëm
6 në këtë rast në këtë sallë gjyqi sot që është nenin 41(6) (a)
7 dhe standardi, pra, për paraburgimin nëse është i domosdoshëm
8 kur kushtet plotësohen. Pra, bisedojmë për këto kushte
9 fillimisht, faktorët lidhur këtë.

10 Neni 41(6) (a) janë plotësuar dhe përmbushur në mënyrë të
11 qartë dhe të padiskutueshme mendoj. Nuk mendoj që ka ndonjë
12 kundërshtim lidhur me këtë është bërë konstatimi i dyshimit të
13 bazuar mirë për dy pika të cilat u lexuan sot këtu dhe që janë
14 konfirmuar kundër z. Fazliu. Pra dhe kjo është plotësuar.

15 Tre pikat e tjera janë faktorët nga neni 41(6) (b), të
16 cilët janë në statut që janë paraqitur si alternativë, pra,
17 secili prej tyre është plotësuar dhe do të ishte i mjaftueshëm
18 për të justifikuar mbajtjen në paraburgim të të akuzuarit. Dhe
19 parashtrimi im është, e nderuar Gjykatëse, që konstatimet janë
20 tërësisht të sakta dhe të gjitha këto të tria janë përmbushur
21 dhe plotësuar dhe të gjitha këto kërkojnë mbajtjen në
22 paraburgim.

23 Pra, tani lidhur me rrezikun e arratisjes, parashtrojmë
24 se z. Fazliu paraqet rrezik të konsiderueshëm arratisjeje
25 pavarësisht dhe jo vetëm, kjo dhe për faktin sepse ka lidhje

1 familjare në Kosovë. Dhe, siç e keni konstatuar ju, e nderuar
2 Gjykatëse, kjo mund të zbusë rrezikun e ikjes, e arratisjes
3 pjesërisht po nuk e zvogëlon atë apo e heq fare.

4 Z. Fazliu, akuzohet për vepra penale të rënda, ajo më
5 kryesorja është përpjekja për të penguar procedurat në këtë
6 Gjykatë dhe gjykimin që është në vazhdim e sipër për krime
7 lufte. Ai përballlet me dënim me burg relativisht të lartë nëse
8 shpallet fajtor pas gjykimit. Dhe ka arsye, pra, të vlefshme
9 për t'u arratisur për të ikur.

10 Fakti që z. Fazliu nuk ka pasaportë shqiptare, nuk e bën
11 atë të pamundur që ai të shkojë në Shqipëri që është një prej
12 vendeve nga ku do të ishte vështirë ose ndoshta edhe e
13 pamundur që të ekstradohej, pra, z. Fazliu mund të fshihet.

14 Ndërsa sa i përket pikës kryesore të rrezikut të ikjes,
15 sot që jemi këtu, z. Fazliu ka treguar mospërfillje të qartë
16 të rregullave të kësaj Gjykate. Ai nuk e dinte se çfarë po
17 bënte kur është -- nuk e dinte çfarë po bënte kur po bënte
18 përpjekje për të penguar procedurat dhe drejtpërdrejt është
19 afruar ku ka kontaktuar dëshmitarin kyç në çështjen që është
20 në zhvillim e sipër këtu, në gjykim e sipër këtu. Ai e dinte
21 shumë mirë, fare mirë atë që po bënte dhe ne e dimë këtë.

22 Avokati i përmendi mungesën e aftësisë së tij për të
23 ditur, pamundësinë e tij për të ditur, për të njohur provat.
24 Do ta shpjegoj edhe këtë pikë në një çast. Disa prej provave
25 kundër z. Fazliu dhe këto lidhen me të tre faktorët që

1 përmendëm, por do të trajtoj rrezikun e ikjes për momentin.
2 Disa nga provat që kemi janë në formën e regjistrimeve audio
3 dhe ku merren udhëzime të drejtpërdrejta për të ndërhyrë tek
4 dëshmitarët dhe duke bërë një gjë të tillë ata e dinin,
5 gjithashtu edhe djali i tij si bashkëkryerës për të -- përfshi
6 edhe djali i tij si bashkëkryerës duke transmetuar mesazhin që
7 në vetvete vërteton që kishin njohuri dhe kuptonin sesi
8 përpiqeshin t'i shmangeshin drejtësisë. Kjo është pika nga ku
9 nisemi.

10 Pra, nuk pajtohem se rreziku i ikjes dhe, po theksoj edhe
11 një herë, sjellja e tij ka treguar dhe një herë mospërfillje
12 të qartë për rregullat e kësaj Gjykate dhe kemi çdo arsye për
13 të besuar se z. Fazliu paraqet rrezik të pengimit të
14 procedurave ashtu siç ka bërë në atë rast edhe pse nuk është
15 akuzuar.

16 Së fundi, pika ku u përmend si peshk i vogël nga Avokati
17 dhe këtu nuk pajtohem me këtë. Do të thoja, e nderuar
18 Gjykatëse, që kjo është në përputhje me konstatimet që keni
19 bërë ku nuk ka peshq të vegjël pastaj kur bëhet fjalë për
20 përpjekje për t'u thënë dëshmitarëve, përfshirë edhe ata të
21 identifikuar nga z. Thaçi si vendimtarë, se, pra, nuk ka peshk
22 të vogël në përpjekje për të ndërhyrë nga këta dëshmitarë dhe
23 për t'u thënë atyre atë që duhet të thonë kur të vijnë në
24 Gjykatë.

25 Parimi themelor i këtij institucioni dhe çdo gjykate

1 është, ka të bëjë me aftësinë e dëshmitarëve për t'u paraqitur
2 në Gjykatë dhe për të dhënë dëshmi të vërtetë dhe për të dhënë
3 mundësinë që drejtësia të vihet në vend në mënyrë të plotë dhe
4 t'i jepet mundësia secilit që të ketë gjykim të drejtë. Z.
5 Fazliu është akuzuar për faktin që ka sjellë djalin e tij, e
6 ka përfshirë djalin e tij në këto veprime dhe ka të bëjë me
7 aftësinë në vetvete për të -- ndikimin, pra, në gjykimin e
8 drejtë të palëve.

9 Z. PESTMAN: [Përkthim] Po. Sa i takon pikës së fundit që
10 ngriti Prokuroria, pyetja ime është kjo, pse një i akuzuar
11 thjesht u thirr dhe tjetri nuk u thirr, tjetri u mor me fletë-
12 arres?. Njëri do vinte vullnetarisht dhe tjetri jo. Dua të
13 kuptoj pse është ndjekur pse është ndjekur një qasje e
14 ndryshme.

15 Diçka tjetër që dua të trajtoj është diçka që ne nuk e
16 dinim, ka një përgjim të një bisede, që unë besoj që është një
17 bisedë se ka ndodhur në objektin e paraburgimit më 2 korrik
18 2023.

19 E nderuar Gjykatëse, nëse vendosni ta rrëzoni kërkesën
20 time për lirim të menjëhershëm apo lirim me kusht të klientit
21 tim, atëherë ju lutem urdhëroni nxjerrjen e plotë të të gjitha
22 materialeve, jo të vetëm këtij incizimi, po të çdo materiali
23 që për ne është i nevojshëm të kundërshtojmë çështjen e
24 Prokurorisë dhe të bëjmë mocionin e duhur për lirimin e
25 klientit tim me kusht. Dhe nëse është e mundur, kjo të bëhet

1 përpara datës 17 dhjetor, pra, unë sërish këmbëngul që klienti
2 im të lirohet bazuar në mungesën e provave.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Përkthim] Dëshiron të kundërpërgjigjet Prokurori për
5 lidhjen e nxjerrjes së materialeve?

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të thënë.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Do të nxjerr një urdhër
8 me gojë pas një pushimi të shkurtër lidhur me paraburgimin e
9 z. Fazliu dhe më pas do ta mbyllim seancën e ditës së sotme.
10 Aktualisht, dëshiroj të pyes palët nëse kanë ndonjë gjë që
11 duan të trajtojnë lidhur me seancën e sotme aktualisht?

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, faleminderit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati mohon me kokë.

14 Në rregull. Do të bëjmë 40 minuta pushim. Do të
15 rikthehem në sallën e gjyqit në orën 2.30.

16 --- Pauza fillon në orën 13.52

17 --- Seanca rifillon në orën 14.35

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani jemi përsëri në
19 seancë. Dhe për procesverbal dua të them se të gjithë palët
20 dhe përfaqësuesit e Zyrës Administrative janë kthyer në sallë.
21 Tani do të jap një urdhër me gojë për paraburgimin.

22 Mbrojtës i -- Avokat i Mbrojtjes, e mora parasysh
23 kërkesën tuaj për lirimin e z. Fazli me kushte. Kam marrë
24 parasysh parashtrimet tuaja se nuk ka prova për akuzat e
25 ngritura ndaj z. Fazliu apo se ekziston rreziku i ikjes së tij

1 dhe se ai është personi që mban familjen dhe se nuk ka rrezik
2 të iki në Shqip.

3 Ju thoni që nuk ekziston rreziku i pengimit të procesit
4 dhe nuk ka prova se do ta bëjë këtë dhe nuk i njeh provat. Për
5 më tepër, ju thatë, pretendoni se nuk ekziston rreziku i
6 kryerjes së krimeve të tjera, sepse mund të urdhëroj që të mos
7 largohet nga Kosova.

8 Gjithashtu mbajta shënim parashtrimet tuaja që z. Fazliu
9 është "peshk i vogël" dhe se ka probleme me mbajtjen e
10 familjes, me shendin e tij.

11 Kam marrë parasysh qëndrimin e Prokurorisë se të gjitha
12 kërkesat e nenit 41(6) përmbushen, dhe se z. Fazliu duhet të
13 vazhdojë të qëndrojë në paraburgim. E di që qëndrimi i ZPS
14 është që ai të përbën rrezik arratije sepse nuk ka një
15 pasaportë shqiptare. Sjellja e tij e mëpasme, duke përfshirë
16 dhe të birin, tregojnë që z. Fazliu e di, ka njohuri se si t'i
17 bëjë bisht drejtësisë.

18 Gjithashtu, ZPS-ja mendon se z. Fazliu akuzohet për vepra
19 të rënda për të cilat mund të dënohet me shumë dënim të rëndë,
20 në qoftë se gjendet fajtor.

21 ZPS-ja thotë që, hedh poshtë atë që e tha avokati i tij
22 se është peshk i vogël.

23 Pasi i shqyrtova të gjitha argumentat, konstatoj se asnjë
24 nga argumentet tuaja, avokat i Mbrojtjes, nuk ndryshojnë
25 vlerësimin që kam bërë unë, të parashikuar në nenin 41(6) të

1 Ligjit, se këto kushte përmbushen. Unë kam dhënë, pra,
2 vendimin tim dhe kam -- në bazë të të cilit, pra, është dhënë,
3 është bërë arrestimi, në parashtrimin F00037, paragrafi 43 dhe
4 81 deri në 92.

5 Duke mos pasur argumente të tjera konkrete nuk jam e
6 bindur se nuk ka prova që të mbështesin konstatimin e nenit
7 41(6) të Ligjit.

8 Gjithashtu mjafton që i akuzuari e ka marrë -- i ka marrë
9 parashtrimet që lidhen me kërkesën e ZPS-së për arrestimin e
10 tij dhe se ai do të marrë gjithashtu aktakuzën materiale për
11 brenda 30 ditësh.

12 Gjithashtu, nuk jam e bindur se z. Fazliu nuk është
13 rrezik arratije. Gjithashtu mendoj që z. Fazliu i ka mjetet,
14 mundësinë të arratiset duke udhëtuar në juridiksione të cilat
15 nuk kanë marrëveshje ekstradimi me Kosovën, përfshirë
16 Shqipërinë, edhe pse nuk ka një pasaportë shqiptare.

17 Fakti që z. Fazliu ka lidhje familjare në Kosovë, vetëm
18 pjesërisht e zbut, por nuk e pakëson rrezikun e arratisjes së
19 tij, sidomos duke pasur parasysh akuzat e bëra ndaj tij dhe
20 rolin e tij dhe të djalit të tij.

21 Fakti që ka kujdes të posaçëm mjekësor në Kosovë, nuk
22 lidhet me rrezikun e arratisjes, sepse ai mund të trajtohet
23 edhe gjetkë.

24 Për sa i takon rrezikut të pengimit të ecurisë së
25 procesit dhe përsëritjes së veprave, konstatoj se asnjë nga

1 argumentat e Mbrojtjes nuk kanë vënë në diskutim konstatimet e
2 bëra në paragrafin 86, 91 të Vendimit për Urdhër Arrestin dhe
3 çështje të lidhura me të.

4 Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha parashtrimet e
5 palëve, vendoj që z. Fazliu të mbetet në paraburgim. Arsyet
6 për burgimin tuaj, z. Fazliu, janë të njëjta me ato që
7 parashtrohen në vendimin në fjalë, paragrafi 43 dhe 81 deri në
8 92, që duhen lexuar bashkë me vendimin aktual.

9 Rrjedhimisht, bazuar në materialet dhe informacionin mbi
10 të cilët bazohet vendimi F00037, dhe në mungesë të ndonjë
11 informacioni kundërthënës, gjej se: Ka dyshim të bazuar se
12 juve jeni përgjegjës për ato që akuzoheni; jeni rrezik ikjeje
13 dhe se do të pengoni ecurinë e procesit dhe do të përsërisni
14 veprat penale.

15 Për më tepër, as kushtet që propozoni ju, Avokati i
16 Mbrojtjes, as një kusht që mund t'i vendoset z. Fazliu nuk
17 janë -- do të ishin të aftë të zbusnin rrezikun e tij.

18 Do ta rishikoj arsyet e paraburgimit tuaj brenda dy
19 muajsh apo më përpara nëse ndryshojnë rrethanat apo bëhet
20 kërkesa siç parashikohet në nenin 41(10) të Ligjit dhe
21 Rregullores 37(21) [Sipas përkthimit] të Rregullores.

22 Në qoftë se ju, avokat i Mbrojtjes, dëshironi të
23 paraqisni parashtrime për rishikimin e paraburgimit, bëjeni
24 këtë jo më vonë se 15 janar 2025. Përgjigja do të ndjekë
25 rregullën 76 të Rregullores.

1 Në qoftë se Mbrojtja vendos të mos parashtrojë ndonjë
2 parashttrimin për këtë, urdhëroj ZPS-në të parashtrojë
3 parashttrimet e veta për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit.
4 Mbrojtja duhet të përgjigjet në qoftë se dëshiron, jo më vonë
5 se data 28 janar 2025.

6 Së fundi, z. Fazliu, keni të drejtë ta apeloni vendimin e
7 sotëm në Gjykatën e Apelit brenda 10 ditësh siç parashikohet
8 në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 59 dhe 170 të
9 Rregullores.

10 Këtu përfundon vendimi im me gojë.

11 Gjithashtu, këtu përfundon edhe seanca e paraqitjes suaj.
12 Dëshiroj të falënderoj palët, Zyrën Administrative për
13 pjesëmarrjen, si edhe përkthyesit, stenografin, teknikët e
14 zërit dhe të sigurisë dhe personelin e sigurisë.

15 Tani këtu përfundon seanca.

16 --- Seanca e paraqitjes së parë mbyllet në orën
17 14.43

18

19

20

21

22

23

24

25